



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:256635

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05573569

K.DH.SH.II.nr.313/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian” nr. 124, kundër debitorit “Radio Capital FM” me seli në Fushë Kosovë, rr. “Dardania”, nr. 272, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Hasan Haxhaj, avokat nga Glllogoci, me bazë përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.1960/23 të dt. 27.12.2023, me datë 15.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit “Radio Capital FM” me seli në Fushë Kosovë, rr. “Dardania”, nr. 272, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.1960/23 të dt. 27.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1960/23 të dt. 27.12.2023, e ka hedhur poshtë si të paafatshëm prapësimin e debitorit “Radio Capital FM” me seli në Fushë Kosovë, i ushtruar ndaj urdhrin përmbartimore P.nr.859/23 i lejuar me datën 13.10.2023 nga përmbartuesi privat Destan Bujupaj.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë debitorit “Radio Capital FM” me seli në Fushë Kosovë, për shkak të shkeljes së barazisë në trajtimi të afateve, me propozimin që ta aprovohet si e bazuar ankesa, ashtu që urdhrin për caktimin e përmbartimit P.nr.859/23 i datës 13.10.2023 i përmbartuesit privat të prishet në tërësi si i pa ligjshëm.

Përgjigje në ankese nuk ka parashtuar kreditori.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Prapësimi i debitorit është i pa afatshëm.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, mbi bazën e dokumentit përmbartimor; Vendimit Nr. 2021/186, dhe numër të referencës 2108/883/KPM/Xh.L, i datës 02.08.2021, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 859/23, të datës 13.10.2023, me të cilin është obliguar debitori “Radio Capital FM”, që, mbi bazën e vendimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej 1,000.00, Euro, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër këtij urdhri, përfaqësuesi i autorizuar i debitorit me datë 08.11.2023 ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se pala debitorë ndaj vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbartimor ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor duke e kundërshtuar gjobën e shqiptuar, mirëpo që kreditori nuk ka trajtuar ankesën e debitorit ku me anë të parashtrësë së datës 14.09.2021 ka njoftuar debitori se ankesa nuk mund të trajtohet për shkak të përbërjes jo të plotë të bordit të ankesave. Andaj, ka shtuar se vendosja e vulës së ekzekutueshmërisë është bërë në mënyrë të kundërligjshme nga kreditori. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit dhe ka theksuar se trajtimi i ankesës së paraqitu nga debitori nuk ka qenë i mundur për arsye të mos emërimit të anëtarit të tretë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, për çka pala është njoftuar me mundësinë për të vazhduar procedurat në gjykatën kompetente, mirëpo që debitori nuk ka vepruar sipas udhëzimeve. Ndërsa, ka theksuar se borxhi i debitorit ndaj kreditorit është real, ashtu që gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin KPPP.nr.1960/23 të dt. 27.12.2023 e ka hedhur poshtë si të paafatshëm prapësimin e debitorit, ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.859/23 i lejuar me datën 13.10.2023 nga përmbartuesi privat Destan Bujupaj.

Dhoma e Shkalles e Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 e as neni 183 të LPK, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet së: “Prapësimi duhet ti dorëzohet gjykatës brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”, ndërsa me dispozitën e nenit 73 paragrafi 3, parashihet së: “Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”. Ne rastin konkret rezulton se debitori urdhrin përmbartimor e ka pranuar me datën 31.10.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedh nga data 01.11.2023, ku rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 07.11.2023. Andaj, Kjo gjykate vlerëson se meqë debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 08.11.2023 përmes postës rekomande, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, dhe rrjedhimisht prapësimi i debitorit është i pa afatshëm.

Në këtë kontekst dhe në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, sepse në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se debitori me datë 31.10.2023 e ka pranuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 859/23, të lejuar më datë 13.10.2023, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, fakt ky i cili vërtetohet nga fletë-kthesa për dorëzim personal të përmbartuesit privat e cila gjendet në shkresat e lëndës. Ndërsa, nga shkresat e lëndës, rezulton se debitori përmes Postës së Kosovës, me datë 08.11.2023, ka paraqitur prapësimin ndaj këtij urdhri, fakt ky i cili vërtetohet nga zarfi i postës me numër rekomande R 5583004.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të debitorit nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë, por nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe sepse debitori nuk ka mundur ti provoj pretendimet e tij ankimore për afatshmërinë e prapësimit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.313/24, me datë 15.04.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi